

PROCESVERBAL

nga seanca e 16-të e Këshillit të Agjencisë për

Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale

mbajtur më 27.4.2022

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Alma Mashoviq, Mr.Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski, Dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët që mungojnë në Këshillin e Agjencisë:/

Në seancë ishte i pranishëm Dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional ishin: Mr. Dragica Ljubevska, Mr. Emilia Petreska Kamenjarova, Vesna Simonovska, Mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, Dr. Ivana Stojanovska

Të pranishëm të tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 16-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

RENDI I DITËS

1. Miaratim i Propozim-procesverblit nga seanca e 2-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 15.4.2022.
2. Miaratim i Propozim-procesverblit nga seanca e15-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 15.4.2022.
3. Shqyrtim i raportit tremujorë për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën 1 janar deri më 31 mars 2022.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR Televizioni Sitel SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 55 paragrafi 5 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR ALSAT-M SHPK Shkup për shkelje të nenit 14 nga Ligji për media.
6. Qëndrimi i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në lidhje me njoftimin e dorëzuar për verifikimin e masave të ndërmarra lidhur me rekomandimet e dhëna të përfshira në raportin përfundimtar të auditorit të certifikuar shtetëror.
7. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 5 vota “për” dhe një abstenim nga z. Trajçev miratoi Procesverbalin e seancës së dytë publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 15.4.2022, me tekst siç ishte propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 5 vota „për“ dhe një abstenim nga z. Trajçev miratoi Procesverbalin nga seanca e 15-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 15.4.2022, me tekst siç ishte propozuar.

Pika 3

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi raportin tremujorë për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike audio dhe Audiovizive për periudhën nga 1 janar deri më 31 mars 2022.

Z. Petrushevski shpjegoi se në këto dokumente në mënyrë precize janë cekur aktivitetet më të rëndësishme që Agjencia i ka punuar tre muajt e parë të këtij viti. Theksoi se Këshilli nuk i voton, por mund të diskutojë dhe në pajtim me përmbajtjen e tyre anëtarët e Këshillit më në detale njihen me aktivitetet e Agjencisë.

Pika 4

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Petreska Kamenjarova e arsyetoi Propozimin për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 55 paragrafi (5) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive. Shpjegoi se bëhet fjalë për Raport nga mbikëqyrja e rregullt programore nga ku është përcaktuar se në emisionin dokumentar argëtues „Brza kujna“, edhe pse janë plasuar prodhime, nuk është e shënuar si program ku duhet të plasohen (vendosen) prodhimet. U është dërguar letër ku thuhet se është kërkuar me shkrim të deklarojnë në lidhje me shkeljen, por kjo nuk është bërë. Në atë drejtim, u propozua për shqiptim të masës vërejtje publike duke dhënë afat për harmonizim me dispozitat nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive prej 30 ditësh pas pranimit të vendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim nr.10-1637/1 datë 8.4.2022 për kryerje të mbikëqyrjes së rregullt programore dhe njëzëri vendosën se ndaj SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 55 paragrafi (5) nga LSHMAAV pasi më 22 mars të vitit 2022 kanë emetuar repriza dhe botime premier nga „Brza kujna“, emision dokumentar-argëtues, që nuk janë të shënura si programe në të cilat janë plasuar prodhime.

Në pajtim me pikën 6 nga Udhëzuesi për përcaktimin e afatit për të vepruar sipas vendimit të Agjencisë për shqiptim të masës (tekst i zbardhur) nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, obligohet që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimit të vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik duhet të përgatisë Vendim për shqiptim të masës vërejtje publike për transmetuesin në vijim.

Sektori për çështje programore pas përfundimit të afatit të përcaktuar në Vendim për vërejtje publike duhet të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrrur (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, duhet të publikojë në ueb faqen e Agjencisë Vendimin.

Pika 5

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Petreska Kamenjarova e arsyetoi Propozimin për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR ALSAT-M SHPK Shkup për shkelje të nenit 14 nga Ligji për media. Sqaroi se bëhet fjalë për Raportin nga mbikëqyrja e rregullt administrative ku është përcaktuar se më 22 mars të vitit 2022, në pjesë të programeve të emetuara, transmetuesi nuk ka publikuar të dhëna të cilat është i detyruar t'i emetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Po ashtu i është dorëzuar kërkesë me shkrim për tu deklaruar për shkeljen e kryer por nuk e kanë bërë. U Propozua për shqiptim të masës vërejtje publike duke dhënë afat për harmonizim të punës prej 45 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit në bazë të të cilit do të kryhet dhe mbikëqyrje kontrolli.

Këshilli i Agjencisë pasi e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative me nr.10-1634/1 datë 8.4.2022 njëzëri vendosi se ndaj SHTR ALSAT-M SHPK Shkup të shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 nga Ligji për media për shkak se më 22 mars të vitit 2022, në pjesë të programit të emetuar, nuk ka publikuar të dhëna që është i obliguar t'i emetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje në veçanti të shërbimit programor.

Në pajtim me pikën 7 nga Udhëzuesi për përcaktim të afatit për të vepruar sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr. 01-6039/1 datë 20.10.2015, detyrohet që në afat prej 45 ditësh nda dita e pranimit të Vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga Ligji për media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik duhet të përgatisë Vendim për shqiptim të masës vërejtje publike për transmetuesin e radhës.

Sektori për çështje programore pas përfundimit të afatit të përcaktuar në Vendim për vërejtje publike duhet të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të konsoliduar nëse subjekti i mbikëqyrrur (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmenduar duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Z.Trajçevski arsyetoi Qëndrimin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në lidhje me lajmërimin e dorëzuar për kontrollin e kryer për masat e marra në lidhje me rekomandimet e dhëna duke përfshirë dhe raportin përfundimtar të revizorit të autorizuar shtetëror. Gjithashtu shpjegoi se vitin e kaluar nga muaji mars deri në muajin qershor Enti shtetëror për revizion ka kryer kontrollin e punës të Agjencisë. Vërejtjet që ishin

dhënë nga ana e tyre ndërkohë janë mënjanuar. Vërejtja e fundit ishte për mënyrën se si ishte zbatuar regjistrimi dhe u bë kontroll për muajin e kaluar nëse është vepruar sipas rekomandimeve nga ku u konstatua se gjithçka është në rregull. Nga ky propozim, Këshilli ka pajtuar me masat e marra dhe aktivitetet që i ka dorëzuar ESHR drejtuar Agjencisë.

Z.Petrushevski tha se shihet qartë se çdo rekomandim i dhënë nga shërbimi i ESHR dhe drejtori janë realizuar. Në pajtim me Ligjin është e nevojshme që Këshilli të merr qëndrim. Shpjegoi se qëndrimi i tij personal është se pajtohet me rekomandimet e realizuara nga ESHR dhe aktivitetet e zbatuara nga ana e ASHMA-së.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Qëndrimin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale se plotësisht është në pajtim me lajmërimet për kontrollin e kryer të masave të marra në lidhje me rekomandimet e dhëna që përmban Raporti përfundimtar i revizorit të autorizuar shtetëror, e vërtetuar nga Agjencia me nr.03-839/2 datë 5.4.2022.

Spektori për mbështetje të punës së drejtorit dhe Këshillit, qëndrimin e lartpërmendur duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pika 7

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr.02-1779/5

09.05.2022

Shkup

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**